



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29.03.2021

Nr: 180

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E SASISË SË FLETËVE TË VOTIMIT QË DO TË PRODHOHEN PËR  
ÇDO QENDËR VOTIMI, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, germa “n”, dhe 2, nenin 97, paragrafi 4, dhe nenin 99, paragrafi 1, germa “a”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V Ë R E N:**

Referuar nenit 19, paragrafi 1, germa “n”, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, nuk përcaktohet kompetencë për miratimin e sasisë së fletëve të votimit për çdo QV.

Referuar nenit 97, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet që sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 përqind, nenit 99, paragrafi 1, ku thuhet që KQZ dërgon në selitë e KZAZ-ve, të ndara në kuti të veçanta për çdo QV, veç të tjerash dhe numrin e nevojshëm të fletëve të votimit, në përputhje me numrin e zgjedhësve të regjistruar në QV, së bashku me numrin shtesë.

Në nenin 10 të Udhëzimit nr.1, datë 5.12.2021 të miratuar nga Komisioni Rregullator përcaktohet afati dhe mënyrën e dërgimit të të dhënave për numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve për çdo QV. Duke qënë se deri në datën e caktuar, 35 ditë para datës së

Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi, për zgjedhjet  
për Kuvend të datës 25 Prill 2021

Data: 29.03.2021

Nr. 180



zgjedhësve, jo të gjithë kryetarët e bashkive sollën këto të dhëna, ato në bazë të nenit 10, paragrafi 3, të Udhëzimit nr.1, ju kërkuan Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Kjo e fundit me shkresë nr. 2276 Prot, datë 19.03.2021 dërgoi të dhënat e kërkuara.

Nga përpunimi i të dhënave, rezulton se në rang vendi janë gjithsej 5199 QV, me gjithsej 3.588.869 zgjedhës. Bazuar në urdhërimet e pikës 4, të nenit 97, të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021, sasia e fletëve të votimit që duhet të prodhohet duke shtuar 2-përqindeshin mbi numrin e zgjedhësve, është 3.660.647(tre milione e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) fletë votimi gjithsej.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, germa “n”, dhe 2, nenin 97, paragrafi 4, dhe nenin 99, paragrafi 1, germa “a”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S A :**

1. Të miratojë sasinë e fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi për Zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, sipas Lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

